



Gratë shtatzënë mund të marrin vaksinën Pfizer kundër COVID-19

Vaksina Pfizer kundër COVID-19 është e rekomanduar për gratë shtatzëna në cilëndo fazë të shtatzënisë së tyre. Ekziston rrezik i lartë për gratë shtatzënë dhe foshnjat e tyre të palindura që të sëmuren rëndë nga COVID-19.

Për të mbrojtur veten dhe foshnjën tuaj të palindur, do të duhet të merrni dy doza të vaksinës Pfizer, tri javë ndaras nga njëra tjetra.

Gratë që janë në gjidhënie mund të marrin vaksinën Pfizer në cilëndo kohë dhe mund të vazhdojnë me gjidhënie pas vaksinimit.

Nëse jeni shtatzënë, caktoni termin për të biseduar me mjekun tuaj në lidhje me vaksinimin.

Për më shumë informacione, vizitoni health.gov.au/covid19-vaccines-languages, ose **thirrni 1800 020 080**.

Për shërbime përkthimi, **thirrni 131450**.



COVID-19
VACCINATION